

## ABA INICIATIVA PËR SUNDIMIN E LIGJIT NË KOSOVË

Në vitin 1999, pas përfundimit të luftes, Shoqata e Avokatëve Amerikan Iniciativa për Sundimin e Ligjit (ish CEELI) në Prishtinë themeloi një program për ndihmë teknike ligjore. Përfaqësues të ABA-s këshilltarë ligjor ishin ndër të parët në teren për të vlerësuar gjendjen e sistemit ligjor pas-konfliktit.

ABA përmes rrjetit të gjerë të avoktëve, gjyqtarëve dhe profesorëve të së drejtes dhe stafit të tij profesional, ABA Iniciativa për Sundimin e Ligjit në Kosovë është duke ndihmuar në ndërtimin e infrastruktures ligjore, kapacitetin njerëzor dhe institucionet lokale të cilat janë të domosdoshme për demokracitë e forta dhe të qëndrueshme.

### FUSHAT NË TË CILAT ËSHTË FOKUSUAR ABA/INICIATIVA PËR SUNDIMIN E LIGJIT NË KOSOVË

- Reforma në Shkollimin Ligjor
- Reforma në Profesionin Ligjor
- Vetëdijësimi Publik mbi Ligjet, Avokatët dhe Sitemin Ligjor
- Mjetet e Vlerësimit për të matur procesin e reformave ligjore

“Tryezat e diskutimit të organizuara në të gjitha rajonet e Kosovës përfaqësojnë iniciativën e parë në këtë nivel gjithëpërfshirës për identifikimin e problemeve të gjykatësve dhe avokatëve në punën e tyre të përditshme në Kosovë. Në të vërtetë, ajo çfarë ka dalë nga këto tryeza diskutimi dhe që po prezantohet para jush shënon punën e përbashkët të Odës së Avokatëve të Kosovës dhe Shoqatës së Gjykatësve me mbështetjen e dhënë nga Shoqata e Avokatëve Amerikan Iniciativa për Sundimin e Ligjit (ABA/ROLI) si dhe financimin e USADI-it. Kjo përmbledhje e problemeve dhe çështjeve të identifikuara është një përkujtues i mirë për Institucionet e Vetëqeverisjes së Përkohshme të Kosovës dhe bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë (UNMIK-un) se numër i konsiderueshëm i këtyre çështjeve presin mbështetjen e tyre për t'u zgjidhur. Kjo nuk na liron ne, Shoqatën e Gjykatësve dhe Odën e Avokatëve të Kosovës të rrimë duarkryq. Një pjesë e mirë e punës na takon ne, prandaj secili bëni punën tuaj dhe kësisoj ndihmoni zgjidhjen e këtyre probleme.”

— Ramë Gashi

KRYETAR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS

“Ajo që po ju prezantohet sot me këtë broshurë është një përmbledhje e shkëlqyeshme e problemeve thelbësore që kanë gjykatësit, avokatët dhe gjyqësori në Kosovë. Çështjet që janë ngritur në këto tryeza dhe që po prezantohen përmes kësaj broshure nuk janë asgjë e re, por unë mund të ju siguroj se përpjekja për t'i prezantuar këto së bashku, pa dyshim është më gjithëpërfshirëse deri më tash prandaj është mundësi e mirë për ne për të ngritur zërin për problemet me të cilat ballafaqohemi. Ne jemi të vetëdijshëm se një pjesë e madhe e këtyre problemeve presin zgjidhje nga ne dhe varen nga përkushtimi, vullneti dhe profesionalizmi ynë, mirëpo pjesa tjetër e këtyre çështjeve do të vazhdojë të varet nga puna dhe vullneti i Qeverisë së Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare (UNMIK). Prandaj, ne llogarisim në punën tuaj!”

— Ymer Huruglica

KRYETAR I SHOQATËS SË GJYKATËSVE TË KOSOVËS



ABA RULE OF LAW INITIATIVE IN KOSOVO  
Pashko Vasa 7  
10000 Pristina, Kosovo  
PHONE & FAX: 381 38 (0) 24 31 61  
www.abanet.org/rol

PROGRAMET E ABA/INICIATIVA PËR  
SUNDIMIN E LIGJIT NË KOSOVË  
financohen nga  
AGJENCIONI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS  
PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (USAID)



## GJYKATËSIT DHE AVOKATËT

DISKUTOJNË PROBLEMET MBI  
SUNDIMIN E LIGJIT NË KOSOVË



2007–2008

## GJYKATËSIT DHE AVOKATËT

DISKUTOJNË PROBLEMET MBI  
SUNDIMIN E LIGJIT NË KOSOVË


Qëllimi i kësaj broshure është informimi më i mirë dhe sensibilizimi i Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës, Odës së Avokatëve të Kosovës, Institucioneve të Vetëqeverisjes së Përkohshme, UNMIK-ut, akterëve të përfshirë në sektorin e drejtësisë dhe publikut të gjerë, për sfidat dhe problemet që ka ky sektor përkatësisht gjykatësit dhe avokatët.

Kjo broshurë është një burim informimi dhe sensibilizimi i problemeve dhe përvojave që gjykatësit dhe avokatët janë duke kaluar në punën e tyre të përditshme në gjykatat e Kosovës.

Broshura prezanton një listë me rreth 30 probleme apo çështje të identifikuara në një seri tryezash diskutimi midis gjykatësve dhe avokatëve në pesë rajonet e Kosovës. Procesi i nxjerrjes së këtyre përfundime ka qenë gjithëpërfshirës dhe është shënuar me pjesëmarrjen e 250 avokatëve dhe gjykatësve kosovarë. Këto përfundime, po ashtu, përfaqësojnë diskutime të gjata midis përfaqësuesve të këtyre dy organizata duke filluar nga dhjetori i vitit 2005 deri në qershor të vitit 2007.

Broshura paraqet, për herë të parë, problemet në formë të përmbledhur, të dy komuniteteve: gjykatësve dhe avokatëve në Kosovë.

## GJYKATËSIT DHE AVOKATËT IDENTIFIKOJNË PROBLEMET ADRESIMI I TYRE ËSHTË THELBËSOR PËR NJË SISTEM JURIDIK ADEKUAT NË KOSOVË



## GJYKATËSIT DHE AVOKATËT

DISKUTOJNË PROBLEMET MBI  
SUNDIMIN E LIGJIT NË KOSOVË

Qëllimi parësor i nxjerrjes së kësaj broshure, nuk është vetëm prezantimi i problemeve të identifikuara por edhe lobimi për të zgjidhur ato. Zgjidhja e tyre do të kishte ndikim të drejtëpërdrejt në krijimin e një ambienti të favorshëm për gjyqësi të pavarur dhe shërbime ligjore të kënaqshme për qytetarin e Kosovës.

Tryezat e diskutimeve midis gjykatësve dhe avokatëve janë organizuar së bashku nga Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK), Shoqata e Gjykatësve të Kosovës (SHGJK) me mbështetjen e Shoqatës së Avokatëve Amerikan / Iniciativa për Sundimin e Ligjit (ABA/ROLI) si dhe financimin e USAID-it.

Këto organizime përfaqësojnë hapat e parë për krijimin e një dialogu të qëndrueshëm midis gjykatësve dhe avokatëve kosovar me qëllim të adresimit të çështjeve dhe problemeve të përbashkëta në fushën e drejtësisë. Idejakryesore e këtyre diskutime ishte shkëmbimi i ideve, përvojave dhe shqetësimeve të përbashkëta me komunitetin e gjerë në fushën e drejtësisë.

Kjo broshurë është kurorëzim i punës dhe diskutimeve të përfunduara në Qershor të vitit 2007.